

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt.13/01/2024 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

**SHKËLQIM BEQAJ**,i datelindjes 27/08/1961, i lindur ne Sarande dhe banues ne Sarande,lagj.1,Bulevardi "Hasan Tahsini",ndertesa nr.6 shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me nr.036075619, me nr.personal G10827052K ,leshuar nga MB me date 08/06/2020,

**GASPËR ARAPI**,i datelindjes 29/12/1989, i lindur ne Tharri dhe banues ne fshatin Shendelli,Konispol,shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasportes nderkombetare me nr.BF1213197, me nr.personal I91229052O ,leshuar nga MB me date 16/10/2017,

**YASIN ATAN**,i datelindjes 17/06/1983, i lindur ne Kirikhan-Turqi dhe banues ne Antalya-Saray mahallesi apt.19/5 Alanya,shtetas turk, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasportes nderkombetare me nr.U25476219,leshuar me date 22/11/2021.

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **VIKINGEN** shpk.

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

#### Neni 1

#### Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **VIKINGEN** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

#### Neni 2

#### Forma Juridike

Shoqeria **VIKINGEN** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **VIKINGEN** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

#### Selia

#### **Shoqeria e ka seline ne adresen:**

**Sarande,lagj.nr.1 Bulevardi "Hasan Tahsini",zk 8641 nr.pasurise 13/138+1-9.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

#### Neni 4

#### **Objekti i veprimtarise**

- **Aktivitetet turistike detare , qe kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi në vijën bregdetare hapësirën detare dhe ujërat e brendëshme, lundrimi për zbavitje dhe aktivitete të tjera ujore si ski në ujë, motor uji, skafe uji, varka**
- **Sherbime turistike per pushuesit ne det dhe toke.**

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 Euro.

Kapitali i shoqerise eshte 100,000 Euro i perbere nga 3 kuota dhe zoterohet nga ortakët e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **SHKËLQIM BEQAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 34,000 Euro, e cila perfaqeson 34 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **GASPËR ARAPI**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 33,000 Euro, e cila perfaqeson 33 % te kapitalit te shoqerise,
3. Ortaku Themelues: **YASIN ATAN**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 33,000 Euro, e cila perfaqeson 33 % te kapitalit te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per çeshtje te tjera si: emerimin dhe shkarkimin e administratoreve, te likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, percaktimin e shperblimeve, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem, i cili do te jete **SHKËLQIM BEQAJ**, i datelindjes 27/08/1961, i lindur ne Sarande dhe banues ne Sarande, lagj.1, Bulevardi "Hasan Tahsini", ndertesa nr.6 shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me nr.036075619, me nr.personal G10827052K ,leshuar nga MB me date 08/06/2020.

Emerimi i administratorit është me një afat pese vjeçar me të drejte riemerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë.

#### Neni 11

##### Kompetencat

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar së bashku në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Administratori/et angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori/et ose ortakët që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzues apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 12

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jete

a. Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.

b. Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin"

c. Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto rast Asambleja e ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".

#### Neni 14

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil, Ligji për QKB, dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 15

##### Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në tre ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën nën nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare **VIKINGEN** shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

GASPER HARAPI

ORTAKËT

SAKELON DEKAS

YASIN ARAN